



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.05.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)

6. Valbona Bala, eksperte EWMI.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtim i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e datës 24.05.2024.

Ndërkohë ju bëj me dije që për arsye objektive, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Llagami, nuk do jetë prezent në mbledhje, kështu që mbledhja në vijim

do të drejtohet nga ana ime si Zëvendëskryetar.

Sipas rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e parë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Kryetar!

Ne paraqesim sot projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”. Bëhet fjalë për kandidatët të cilët kanë fituar të drejtën e provimit të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, pra të drejtën e ... të formimit fillestar si magjistratë në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik që do vijë, 2024-2025. Bashkëlidhur projektvendimit ne paraqesim relacionin. Nëse marrë dakordësinë e kolegëve, në mënyrë të përmbledhur po bëj parashtresat e këtij relacioni.

Ndër të tjera përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket rekrutimit të kandidatëve për gjyqtarë, gjen rregullim në nenin 32 në Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve (është detyrim ligjor i parashikuar nga neni 32) në kuadër të zhvillimit të karrierës gjyqësore, përfshirë edhe të atyre për në formimin fillestar për magjistrat, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit nr. 75/2019. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja “a”, procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendimin e Këshillit, ndër të tjera, “jo më vonë se 7 ditë nga publikimi i listës përfundimtare të kandidatëve për formim fillestar në Shkollën e Magjistraturës”.

Brenda afatit 7-ditor ne paraqesim projektvendimin dhe relacionin të cilin po prezantoj përpara Këshillit.

Në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës

së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar, për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2024-2025, në kushtet kur Shkolla e Magistraturës, me shkresën nr. {...} prot, datë 17.05.2023 (2024), protokolluar në Këshill me aktin nr. {...}, datë 20.05.2024, ka përcjellë listën përfundimtare të kandidatëve fitues për profilin gjyqtar në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2024-2025. Pra edhe një herë shkresa është nr. {...} prot, datë 17.05.2024.

Në vijim, sipas Kreut V, Seksioni A, pika 2, të aktit nënligjor si më lart, “Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat”. Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2024-2025, do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Referuar listës përfundimtare të kandidatëve fitues për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik që do të fillojë, 2024-2025, rezulton të jenë 20 kandidatë, pra në përputhje me numrin e përcaktuar nga Këshilli me vendimin nr. 31, datë 31.01.2024.

Në procesin e verifikimit do të përfshihen anëtarët e përhershëm të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, si edhe anëtari zëvendësues i Komisionit, z. Ridvan Hado.

Sa i përket shortit, propozohet të ndiqen të njëjtat rregulla si dhe më parë, ku në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ndërsa në një enë tjetër të hidhen shiritat e letrës me emrat e 20 kandidatëve.

Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator më pas për verifikimin e (propozojmë ndarjen e kandidatëve të cilët do duhet të verifikohen nga secili prej katër relatorëve):

- 6 (gjashtë) kandidatëve nëse ato do të më përkasin mua, pra 6 kandidatë në emrin tim;

- 6 (gjashtë) kandidatëve nëse do të jetë emri i z. Koça;
- 3 (tre) kandidatëve nëse do të jetë emri i z. Toro- për shkak të ngarkesës;
- 5 (pesë) kandidatëve nëse do të jetë emri i z. Hado.

Pra këto janë propozimet tona. (6:6:5:3)

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ne propozojmë që ai të bëhet në dy pika.

Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga 20 kandidatët për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025, për të cilët fillon procedura e verifikimit sipas pikës 1 të këtij projektvendimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime në lidhje me mekanizmin e hedhjes së shortit të propozuar nga relatori?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për të hedhur shortin.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit futen shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Alban Toro i cili do të jetë relator për 3 kandidatë, z. Markelian Koça i cili do të jetë relator për 6 kandidatë, z. Klodian Kurushi i cili do të jetë relator për 6 kandidatë, z. Ridvan Hado i cili do të jetë relator për 5 kandidatë.

Në enën e dytë të qelqit futen me radhë shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...},

z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

Përzgjidhet emri i relatorit, që rezulton z. Klodian Kurushi. Z. Kurushi do të jetë relator për 6 kandidatët e përzgjedhur si vijon: 7. znj. {...}, 5. znj. {...}, 2. z. {...}, 10. z. {...}, 14. znj. {...}, 16. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit, që rezulton z. Alban Toro. Z. Toro do të jetë relator për 3 kandidatët e përzgjedhur si vijon: 9. z. {...}, 12. z. {...}, 20. znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit, që rezulton z. Markelian Koça. Z. Koça do të jetë relator për 6 kandidatët e përzgjedhur si vijon: 4. znj. {...}, 3. znj. {...}, 6. znj. {...}, 11. z. {...}, 17. znj. {...}, 19. z. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit, që rezulton z. Ridvan Hado. Z. Hado do të jetë relator për 5 kandidatët e përzgjedhur si vijon: 13. znj. {...}, 15. znj. {...}, 8. z. {...}, 1. znj. {...}, 18. znj. {...}.

Ilir Rusi: Ka diskutime mbi mënyrën e hedhjen e shortit dhe rezultat e saj?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit të përditësuar sipas rezultateve të rezultuara nga shorti i sapo hedhur.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2024-2025.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
2. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
3. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
4. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
5. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
6. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
7. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
8. Për kandidatin z. {...}, relator z. Ridvan Hado;
9. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
10. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
11. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
12. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
13. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
14. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
15. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
16. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
17. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
18. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Ridvan Hado;
19. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
20. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të

Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.05.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.256, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |

8. *Yllka Rupa* (anëtare)

9. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Irena Plaku*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

3. *Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*

5. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*

6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*

7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtim i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.256, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Ilir Rusi: Në vijim, vazhdojmë me pikën 2 të kësaj mbledhjeje që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të

drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.256, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Toro.

Bëj me dije që në shqyrtimin e kësaj pike të këtij rendi dite, nuk do të marrë pjesë anëtarja zonja Irena Plaku.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kuadër të përpjekjeve që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) për të plotësuar vakancat në sistemin gjyqësor, ndër të tjera edhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, janë iniciuar procedurat e lëvizjes paralele në këtë gjykatë dhe konkretisht me vendimin nr.256 deri në 258, datë 24.05.2023 të KLGJ-së, ku është vendosur hapja e tre procedurave të lëvizjes paralele në këtë gjykatë.

Natyrisht objekti i këtij relacioni nuk është hapat procedurale që ka bërë Këshilli për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në këto konkurrime, por dorëheqja që ka paraqitur znj. {...} për pozicionin e lirë 256, datë 24.05.2023 në fushën e të drejtës administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë e cila në dorëheqjen e saj shprehet se: Unë {...}, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, paraqes këtë kërkesë për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr.256, datë 24.05.2023 "Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”. Natyrisht, duke qenë që ky është një fakt juridik i përfshirë në rregullimet e akteve nënligjore të KLGJ-së dhe konkretisht vendimit 320, 17.09.2020, pika 107, Seksioni “D”, Kreun VI, ku përcaktohet se: “Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 54, 55, 59 dhe 60, të këtij vendimi”; si dhe në pikën 108 Seksioni “DH” dhe në pikën 109 Seksioni “E”. Gjithmonë duke mbajtur në konsideratë edhe pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020.

Në kushtet kur vullneti i magistratit është thelbësor në këtë fazë të konkurrimit, relatorit i mbetet vetëm t’ju sugjerojë dhe ka përgatitur projektvendimin, në dispozitivin e

të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 256, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke redaktuar sigurinë e anonimatit të subjektit.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr.256, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 256, datë 24.05.2023, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.05.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |

5. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)
10. *Emona Muçi* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Dorina Priti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)*
6. *Valbona Bala, eksperte EWMI.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Në vijim vazhdojmë me pikën 3 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Pa humbur kohë po filloj relatimin mbi projektvendimin që ne kemi propozuar për të miratuar në Këshill, në lidhje me fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

I. Mbi procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Në Mbledhjen Plenare të datës 02.05.2024, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve (neni 147/a, pika 1, shkronja “a”, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 86, shkronja “ç”, i Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar), me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë të përmendur më lart u

përcaktuar deri më datë 16.05.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të prezantuar si më sipër, u paraqitën gjithsej 8 (tetë) kandidatura: 1. Znj. {...}, 2. Znj. {...}, 3. Z. {...}, 4. Z. {...}, 5. Znj. {...}, 6. Znj. {...}, 7. Znj. {...}, 8. Znj. {...}.

Përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta ose të specializuara, gjen rregullim edhe në Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë dispozitë përcaktohet detyrimi i Këshilli për të verifikuar kandidatët që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar edhe procedura të detajuara përmes vendimit nr. 75, datë 23.05.2019. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c”, procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, ndër të tjera, “jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë”. Në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin respektiv nr. 247, të datës 02.05.2024.

II. Mbi procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira, në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245, nr. 246, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Mbledhjen Plenare të datës 02.05.2024, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, Këshilli me vendimet nr. 244, nr. 245, nr. 246, datë 02.05.2024 vendosi hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicione të lira në

fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit për procedurën e ngritjes në detyrë sa më lart u përcaktua deri më datë 16.05.2024.

Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245, nr. 246, datë 02.05.2024 për pozicionet e lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e të drejtës civile të prezantuara si më sipër, u paraqitën gjithsej 14 (katërmbëdhjetë) kandidatura si më poshtë: 1. Znj. {...}, 2. Znj. {...}, 3. Z. {...}, 4. Z. {...}, 5. Z. {...}, 6. Znj. {...}, 7. Znj. {...}, 8. Znj. {...}, 9. Znj. {...}, 10. Znj. {...}, 11. Z. {...}, 12. Z. {...}, 13. Znj. {...}, 14. Znj. {...}.

Njëkohësisht, lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, Këshilli ka miratuar edhe procedurat e detajuara përmes Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019: “Jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë”, duhet të nisë procesi i verifikimit të kandidaturave i cili fillon me vendimin që duhet të marrë Këshilli për këtë qëllim. Respektivisht, në zbatim të këtij rregulli të mësipërm, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet respektive nr. 244, 245, 246, datë 02.05.2024.

III. Mbi projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245, nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe në Gjykatat e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas vendimeve si më lart të Këshillit, kanë kandiduar gjithsej 21 (njëzet e një) kandidatë, të cilët unë i përmenda më lart, duke i renditur një nga një edhe arsyet e kandidimit si dhe verifikimet nëse kanë

pasur këta kandidatë në proces kandidime të tjera të mëparshme. Ka rezultuar se:

Për kandidatin z. {...}, i cili ka aplikuar për pozicionet nr. 244, 245 dhe nr. 246, ka kandiduar më parë për pozicionet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm të shpallura me vendimet nr. 502, nr. 503 dhe nr. 504, datë 21.11.2022 dhe për këtë kandidat vijon procedura në fazën e përzgjedhjes (pra për tre pozicionet e shpallura në vitin 2022). Ai kandidoi edhe më parë për ngritje në detyrë (referuar pozicionit nr. 239/2023, të cilin Këshilli nuk e konsideroi kandidaturë të vlefshme dhe u shpreh në vendimin nr. 57/2024); Në proces rezulton se kandidati të ketë 6(gjashtë) kandidime për ngritje në detyrë.

Kandidatja znj. {...}, e cila ka aplikuar për pozicionet nr. 244, 245 dhe nr. 246 datë 02.05.2024, ka kandidime në proces ato të pozicioneve të lira të shpallura më përpara nga ky Këshill me nr. 239, 240 dhe nr. 241, datë 24.05.2023, për të cilat Këshilli me vendimin nr. 159, datë 27.03.2024, ndër të tjera ka vendosur: “Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 239, nr. 240 dhe nr. 241, datë 24.05.2023.” Në proces rezulton të ketë 6 (gjashtë) kandidime për ngritje në detyrë.

Kandidatja znj. {...}, e cila shpreh interesin për pozicionin nr. 244 dhe nr. 247, datë 02.05.2024, ka aplikuar më parë për pozicionet nr. 500/2022 dhe nr. 501/2022 për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe për pozicionin nr. 246/2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Me shkresën nr. {...}, datë 16.05.2024 kjo candidate deklaroi tërheqjen nga kandidimi për pozicionet nr. 500 dhe nr. 501 të vitit 2022 për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë. Kjo candidate ka aplikuar edhe për tre pozicione të lira të lëvizjes paralele (janar 2024) të cilat Këshilli nuk i konsideroi aplikime të vlefshme. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e saj për heqjen dorë nga pozicionet nr.500/2022 dhe 501/2022, rezulton që kjo candidate të ketë 3 (tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë.

Kandidatja znj. {...}, e cila aplikon për pozicionin nr. 245, datë 02.05.2024, ka

aktualisht në proces kandidimin për lëvizjen paralele nr. 80/2024. Rezulton se kjo kandidatë ka 2 (dy) aplikime në proces të vlefshme.

Kandidatja Znj. {...}, ka aplikuar për pozicionin 247/2024. Kjo kandidatë ka në proces pozicionet nr. 501, 502 dhe 504, datë 22.11.2022. Me kërkesën nr. {...} prot., datë 16.05.2024 ka deklaruar tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 501/2022. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e saj për heqjen dorë nga kandidimi për pozicionin nr.501/2022, rezulton që kjo kandidatë të ketë 3 (tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë.

Kandidati z. {...} ka aplikuar për pozicionin 245/2024. Ky kandidat ka në proces kandidimin për: 1) pozicionin e lirë në Gjykatën e Lartë të shpallur me vendimin nr.178, datë 11.05.2022; 2) pozicionet nr. 504/2022 dhe 241/2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Me shkresën nr. {...} prot., datë 15.05.2024 deklaroi tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 504/2022. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e tij për heqjen dorë nga pozicioni nr.504/2022, rezulton që ky kandidat të ketë 3 (tre) kandidime të vlefshme për procesin e ngritjes në detyrë.

Kandidatja Znj. {...}, ka aplikuar për pozicionin 245/2024. Kjo kandidatë ka në proces pozicionet nr. 235, 244, 245, datë 24.05.2023. Me shkresën nr. {...} prot, datë 16.05.2024 ka deklaruar tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 235/2023. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e saj për heqjen dorë nga pozicioni nr.235/2023, rezulton që kjo kandidatë të ketë në proces 3 (tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë.

Kandidatja Znj. {...}, ka aplikuar për pozicionin 245/2024. Kjo kandidatë kishte në proces pozicionet nr. 79, 80, 81, datë 20.02.2024 të lëvizjes paralele. Me shkresën nr. {...} prot., datë 17.05.2024 (kërkesë e ardhur në rrugë postare e dërguar në postë më datë 15.05.2024) ka deklaruar tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 79/2024. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e saj për heqjen dorë nga pozicioni i lëvizjes paralele nr.79/2024, rezulton që kjo kandidatë të ketë 3 (tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë dhe lëvizje paralele.

Kandidati z. {...} ka aplikuar për pozicionin 245/2024 dhe 246/2024. Ky kandidat

ka në proces në verifikim pozicionet nr. 235/2023, 236/2023 dhe 240/2023. Me shkresën nr. {...} prot., datë 16.05.2024 deklaroi tërheqjen nga kandidimi për pozicionet nr. 235/2023 dhe nr. 236/2023. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e tij për heqjen dorë nga pozicionet nr. 235/2023 dhe nr. 236/2023, rezultoi që ky kandidat të ketë aktualisht në proces 3 (tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë.

Kandidatja znj.{...}, ka aplikuar për një pozicion atë me nr. 244/2024. Kjo kandidatë ka në proces aplikimet për pozicionet nr. 500/2022, nr. 501/2022 dhe nr. 236/2023. Me kërkesën e saj datë 15.05.2024 deklaroi tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 236/2023. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e saj për heqjen dorë nga pozicioni nr.236/2023, rezultoi që kjo kandidatë të ketë aktualisht 3 (tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë.

Kandidatja znj.{...} ka aplikuar për pozicionin 247/2024. Kjo kandidatë ka në proces aplikimet për pozicionet nr. 502/2022, nr. 503/2022 dhe nr. 239/2023. Me shkresën nr. {...} prot., datë 14.05.2024 deklaroi tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 239/2023. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e saj për heqjen dorë nga kandidimi për pozicionin nr.239/2023, rezultoi që kjo kandidatë të ketë 3(tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë.

Kandidatja znj. {...} ka aplikuar për pozicionin 247/2024. Kjo kandidatë ka në proces aplikimet për pozicionet nr. 499/2022, nr. 501/2022 dhe nr. 244/2023. Me shkresën nr. {...} prot., datë 15.05.2024 deklaroi tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 244/2023. Duke e konsideruar të vlefshëm vullnetin e saj për heqjen dorë nga pozicioni nr.244/2023, rezultoi që kjo kandidatë aktualisht të ketë në proces 3 (tre) kandidime të vlefshme për ngritje në detyrë.

Kandidatja znj. {...} ka aplikuar për pozicionin 247/2024. Kjo kandidatë ka në proces aplikimet për pozicionet nr. 501/2022 (ngritje në detyrë), dhe nr. 76 dhe nr. 81 të lëvizjeve paralele, pra përpara këtij kandidimi ka pasur tre aplikime në proces. Me komunikimin elektronik, datë 19.05.2024 ajo deklaroi tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 81/2024 (një nga pozicionet e lëvizjes paralele). Në vijim me komunikimin elektronik datë 22.05.2024 deklaroi heqjen dorë nga kërkesa për heqje dorë, për

pozicionin nr. 81. Rezulton se kjo kandidate, pasi ka paraqitur komunikimin elektronik të heqjes dorë nga heqja dorë e datës 22.05.2024, rezulton që kjo kandidate ka në proces 4 (katër) aplikime të ngritjes në detyrë dhe në lëvizje paralele, të marra së bashku.

Rezulton se kandidatët e tjerë që të cilët kanë aplikuar për pozicionet e lira nr. 244/2024, 245/2024, 246/2024 dhe 247/2024 të mos kenë më tepër se 3 aplikime në proces për ngritje në detyrë dhe/ose lëvizje paralele.

IV. Vlerësimi i Komisionit

Referuar nenit 48, pika 6 e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës”.

Duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore për kandidatët me më tepër se 3 aplikime (të konstatuara më lart në këtë relacion që parashtroj përpara Këshillit), të vlefshme do të konsiderohen sipas propozimit tonë, ato të bëra më parë në kohë, prej tyre, referuar dispozitës së lexuar më lart (neni 48, pika 6). Në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, të vlefshme do të konsiderohen ato kandidime që janë të renditura sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura nga Këshilli, duke filluar nga ai i shpalluri më parë. Më konkretisht:

- znj. {...}, e cila ka aplikuar në pozicionet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, duke pasur në procedurë aplikimet për pozicionet nr. 239, 240 dhe nr. 241. Rezulton se kjo kandidate ka në proces aktualisht (me tre kërkesat e fundit) 6 aplikime. Komisioni propozon që për këtë kandidate të mos fillojë procedura e verifikimit për pozicionet nr. 244/2024, nr. 245/2024 dhe nr. 246/2024 pasi këto aplikime nuk janë të vlefshme bazuar në nenin 48/6 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, si edhe duke mbajtur në konsideratë që qëndrimin e Gjykatës së Lartë, të shprehur për këtë situatë, me vendimin nr. 00-2020-

995, datë 28.12.2020 (pra ligjin dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë që ka interpretuar këtë dispozitë ligjore në një rast konkret).

- Z. {...}, i cili ka aplikuar në pozicionet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, duke pasur në procedurë aplikimi pozicionet e mëparshme nr. 502, 503 dhe 504. Rezulton se ky kandidat të ketë aktualisht edhe me tre aplikimet e fundit 6 aplikime në proces. Komisioni propozon që për këtë kandidat të mos fillojë procedura e verifikimit pasi nuk ka kandidime të vlefshme, bazuar në parashikimin ligjor të nenit 48/6 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, si edhe në qëndrimi i mbajtur për këtë situatë në këtë rast ligjor nga Gjykata e Lartë me vendimin e datës 28.12.2020, të përmendur më lart.

- Znj. {...}, e cila ka aplikuar në pozicionin nr.245/2024, duke mbajtur në vëmendje qëndrimin e Këshillit bazuar në praktikën e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, vlerëson se ka aplikim të vlefshëm për pozicionin nr. 245/2024, pasi në proces sipas verifikimeve që kemi bërë neve, ajo rezulton të ketë tre aplikime të vlefshme.

- Znj. {...}, e cila ka aplikuar në pozicionin nr.244/2024 dhe nr. 247/2024, duke shfaqur vullnetin për heqjen dorë nga pozicionet 500/2022 dhe 501/2022, rezulton të ketë 3 (tre) aplikime të vlefshme që janë nr. 246/2023, nr. 244/2024 dhe nr. 247/2024. Pra janë të gjitha aplikime për ngritje në detyrë. Këto i konsideron Këshilli si aplikime të vlefshme. Mbajtur në vëmendje qëndrimin e Këshillit, Komisioni vlerëson se ka aplikime të vlefshme për pozicionin nr. 244 dhe nr. 247/2024 dhe duhet të fillojë procedura e vlerësimit për këtë kandidate (pra vetëm për tre aplikime që i referohen rastit të ngritjes në detyrë).

- Znj. {...}, e cila ka aplikuar në pozicionin nr.247/2024. Me postë elektronike datë 19.05.2024 ka deklaruar tërheqjen nga kandidimi për pozicionin nr. 81 të lëvizjes paralele. Po nëpërmjet komunikimit elektronik datë 22.05.2024 deklaroi heqjen dorë nga kërkesa për heqje dorë, për pozicionin nr. 81. Duke qenë se kjo kandidate ka ende në garë pozicionet nr. 501/2022, 76/2024 dhe 81/2024 (që janë të dyja në lëvizje paralele), nuk do të ketë, sipas vlerësimit tonë, aplikim të vlefshëm për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247/2024. Komisioni propozon që për këtë kandidate të mos fillojë procedura e verifikimit parashikuar në nenin 43/5 dhe 48/6 të ligjit nr. 96/2016

“Për statusin”, si edhe qëndrimin që ka mbajtur Gjykata e Lartë për këtë qëllim në vendimin e datës 28.12.2020 (me nr. vendimi 00-2020-995).

V. Struktura e projektvendimit.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245, nr. 246 datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për kandidatët që ne i përmendëm më lart. Nuk po i lexoj një nga një. Janë të përmendur në projektvendim dhe në relacion.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme. Në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 18 (tetëmbëdhjetë) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazhdim tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 6 (gjashtë) kandidatë. Pra janë 18, tre anëtarë të Komisionit, secili të marrë nga 6 kandidatë.

Në pikën 3 të projektvendimit Komisioni propozon që të parashikohet e drejta e ankimit për kandidatët për të cilët nuk do të fillojë procedura e verifikimit, me përcaktimin se mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pra propozojmë që duke shtuar, siç e thamë edhe në relacion, në projektvendim,

pika 3 e projektvendimit të formulohet si më poshtë:

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit nga subjektet (shtesa) për të cilët nuk fillon procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit për vëmendjen.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua edhe me redaktimin dhe shtesën e bërë përgjatë relatimit nga zoti Kurushi?

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse për momentin nuk ka diskutime për sa u bënë plotësime edhe shtesa nga relatori, ftoj administratën në hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Në enën e parë të qelqit vendosen shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Alban Toro (relator për 6 kandidatë), z. Klodian Kurushi (relator për 6 kandidatë), z. Markelian Koça (relator për 6 kandidatë).

Në enën e dytë të qelqit vendosen shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: Znj. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Z. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Znj. {...}, Z. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet emri i relatorit të parë i cili rezulton z. Alban Toro. Zoti Toro do të jetë relator për kandidatët e përzgjedhur si vijon: 16. Znj. {...}, 13. Znj. {...}, 15. Znj. {...}, 2. Znj. {...}, 18. Z. {...}, 11. Z. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të dytë i cili rezulton z. Markelian Koça. Zoti Koça do të jetë relator për kandidatët e përzgjedhur si vijon: 3. Z. {...}, 9. Znj. {...}, 10. Z. {...},

12. Z. {...}, 6. Znj. {...}, 7. Znj. {...}.

Përzgjidhet emri i relatorit të tretë i cili është z. Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për kandidatët e përzgjedhur si vijon: 1. Znj. {...}, 8. Znj. {...}, 17. Znj. {...}, 4. Z. {...}, 14. Znj. {...}, 5. Znj. {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit për hedhjen e shortit.

Ftoj anëtarët për diskutime, duke marrë në konsideratë përditësimin e projektvendimit sipas shortit të hedhur dhe plotësimit të bërë për pikën 3 të këtij projektvendimi nga relatori z. Kurushi. Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Unë kam një rikonsiderim të atij propozimit që bëra në lidhje me pikën 3 të projektvendimit. E para, propozoj që duke filluar brenda afatit 5-ditor, propozoj jo nga dita e njoftimit por nga e nesërmbja e njoftimit të këtij vendimi. Kjo është pika e parë e propozimit. Ndërsa, nga ajo pjesa tjetër, duke menduar që ky vendim u drejtohet të gjithë kandidatëve të cilët janë në procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore, mendoj që duhet ta rikonsideroj edhe një herë propozimin e bërë më përpara, duke propozuar variantin e parë që ne kemi bërë, meqenëse u drejtohet të gjithëve, nuk duhet të bëjmë diferencë mes kandidatëve për të cilët fillon procedura e verifikimit dhe atyre që nuk fillon, pasi të gjithë kandidatëve u njihet e drejta e ankimit kundër këtij vendimi për procedurat që kemi ndjekur, për relacionin dhe për çdo kriter që ne kemi diskutuar në këtë mbledhje. Kështu që rikonsideroj edhe një herë propozimin duke i qëndruar propozimit të parë me ndryshimin/me plotësimin “nga e nesërmbja e shpalljes së vendimit”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime, duke marrë në konsideratë hedhjen e shortit dhe saktësimet fundore të sapo bëra nga zoti Kurushi?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord me propozimet e mia së fundmi për rregullimin e pikës 3 të këtij projektvendimi. Faleminderit!

Ilir Rusi: Atëherë ky projektvendim u hodh në votim duke marrë në konsideratë përditësimet të cilat ndodhën nga shorti i sapo hedhur, njëkohësisht edhe nga relatimi fundor i bërë nga z. Kurushi dhe saktësimin në lidhje me pikën 3 të këtij vendimi. Kështu që edhe unë jam dakord në lidhje me këtë projektvendim, duke marrë në konsideratë përditësimet e hedhjes së shortit dhe njëkohësisht edhe saktësimet fundore të z. Kurushi si relator i këtij akti, në lidhje me pikën 3 të tij.

Vendim “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024 si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 247, datë 02.05.2024; si edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 244, nr. 245 dhe nr. 246, datë 02.05.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
2. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
3. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
4. Për kandidatin z. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
5. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
6. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
7. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
8. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
9. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Markelian Koça;
10. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
11. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro;
12. Për kandidatin z. {...}, relator z. Markelian Koça;
13. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
14. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
15. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
16. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Alban Toro;
17. Për kandidaten znj. {...}, relator z. Klodian Kurushi;
18. Për kandidatin z. {...}, relator z. Alban Toro.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.05.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 02.03.2020 - 14.06.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:20 dhe mbaroi në orën 11:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Fatmira Luli | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 6. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |

9. Yllka Rupa (anëtare)

10. Emona Muçi (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. **Naureda Llagami.**

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Dorina Prifti, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice. (në sallë)

6. Valbona Bala, eksperte EWMI.

7. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 02.03.2020 - 14.06.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relator znj. Irena Plaku).

Ilir Rusi: Në vijim kësaj mbledhjeje vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 02.03.2020 - 14.06.2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më tej fjalën

relatores znj. Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur relacionin mbi projektvendimin për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e komandimit në Këshill të gjyqtarës znj. {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore për kandidimin në ngritje në detyrë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimet nr.239 deri në 247, të datës 24.05.2023, si dhe vendimet nr.235, 236, 237 dhe 238, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në 9 (nëntë) pozicione si dhe në 4 (katër) pozicione të lira në Gjykatën Administrative të Apelit.

Pas përfundimit të afateve të aplikimit për këto vende kanë aplikuar disa kandidatë, ndër të cilët është edhe kandidatja {...} e cila në përfundim të procedurës së verifikimit të tre kriterëve të kandidimit, konkretisht me vendimin nr.130, datë 13.03.2024, ka vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet nr. 239, nr. 244, nr. 247, të datës 24.05.2023.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për ngritje në detyrë, në secilin prej vendimeve të shpalljes së pozicioneve të lira është parashikuar se: “Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave përkatëse, fillon procesi i vlerësimit etik dhe profesional...”

Sa më sipër, bazuar në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, por edhe në Programin e Vlerësimeve të miratuar nga Këshilli, ky i fundit duhet të fillojë me përparësi procedurën e përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional, për kandidatët e verifikuar, të cilët si rregull kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit në vitin përkatës, për periudhën e vlerësimit që përfshin vitin e fundit kalendarik, përpara kandidimit.

Për gjyqtaren {...}, e cila ka kandiduar për ngritjen në detyrë, në pozicionet nr. 239, nr. 244, nr. 247, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 319 datë 14.06.2023 ka

vendosur mosfillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e gradimit, për shkak të pamundësisë së kryerjes së vlerësimit (mungesën e përvojës minimale si gjyqtar prej një viti). Ndërsa, rezulton se me vendimin nr. 416, datë 10.10.2022 ka miratuar raportin e vlerësimit etik dhe profesional për vitet 2017-2019.

Gjyqtarja në kohën e kandidimit ka qenë e komanduar në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional nga data 02.03.2020 deri në 02.03.2024.

Lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar, në nenin 70, pika 3 të Ligjit për Statusin, është parashikuar se “Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për vlerësimin e magistratëve në skemën e delegimit.”

Gjithashtu në nenin 53, pika 10 parashikohet se: “...10. Magistratit të komanduar i bëhet vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni në të cilin magistrati është komanduar, në përputhje me kriteret dhe procedurën që zbatohet për anëtarët e tjerë të këtij institucioni, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Nivelet e këtij vlerësimi njihen si nivele vlerësimi në kuptim të ligjit”.

Për gjyqtarët e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, me vendimin e KLGJ nr. 159, datë 05.04.2023, Këshilli ka miratuar rregullat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të cilat janë pjesë e “Skemës së vlerësimit të gjyqtarëve”. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional i propozon mbledhjes plenare, fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e komandimit në Këshill për gjyqtaren {...}, e cila ka aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, pas hyrjes në fuqi të këtyre rregullave dhe veç periudhës 2017-2019 (vlerësim i parë) për të nuk ka një vlerësim tjetër të fundit, si dhe nga vlerësimi i fundit etik dhe profesional kanë kaluar më shumë se dy vjet.

Lidhur me periudhën e vlerësimit në nenin 6, pika 2 dhe 3, të vendimit nr.159, datë 05.04.2023 “Rregullat për vlerësimin e etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor” përcaktohet se: “ 2. Këshilli kryen vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit të komanduar pas përfundimit të afatit të komandimit. Si

rregull, gjyqtari i komanduar vlerësohet vetëm një herë për të gjithë periudhën e komandimit. 3. Nëse gjatë periudhës së komandimit, gjyqtari kandidon për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë dhe për të nuk ka vlerësime të kryera apo që mund të kryhen sipas programeve të vlerësimit të miratuara nga Këshilli, ky i fundit bën vlerësim për periudhën e komandimit deri në momentin e kandidimit, vetëm nëse nga vlerësimi i fundit etik dhe profesional, kanë kaluar më shumë se dy vjet”.

Duke qenë se vlerësimi i fundit për të është viti 2017-2019, Komisioni ka vlerësuar se procedua e vlerësimit për gjyqtaren {...} të fillojë nga data e komandimit, datë 02.03.2020 dhe të përfundojë në datën 14.06.2023, datë në të cilën gjyqtarja ka kandiduar për ngritje në detyrë për pozicionet e shpallura të lira me vendimet nr. 239, nr. 244, nr. 247, datë 24.05.2023.

Procesi i vlerësimit etik dhe profesional për periudhën si më sipër do të zhvillohet mbi bazën e burimeve të vlerësimit të përcaktuara në nenin 77 të Ligjit për Statusin si dhe nenin 8 të vendimit nr.156, të datës 05.06.2023 (*vendimi është 159, 05.04.2023*) të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky vlerësim do të zhvillohet mbi bazën e rregullave të përcaktuara në nenet 71 e vijues të ligjit si dhe të rregullores.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 147/a, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, në nenin 61, 63 dhe 86, të ligjit nr. 115 si dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën e komandimit në Këshill të gjyqtarës {...}, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë”.

Në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën 02.03.2020 - 14.06.2023, për gjyqtaren znj. {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së nëpunëses përgjegjëse për vlerësim në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe ka plotësuar kriteret ligjore për ngritje në detyrë.

Në pikën e dytë përcaktohet caktimi i relatorit, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional, sipas nenit 14 të

vendimit nr. 159, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së fundi, përcaktohet dhe hyrja në fuqi e këtij vendimi, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime për sa u relatua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për hedhjen e shortit.

Procedura e hedhjes së shortit si vijon:

Në enën e qelqit vendosen shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi, znj. Irena Plaku dhe znj. Yllka Rupa.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Relatore për vlerësimin e gjyqtares {...}, përzgjidhet znj. Emona Muçi.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime mbi projektvendimin duke marrë në konsideratë edhe përditësimet e ndodhura për shkak edhe të hedhjes së shortit?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vijojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, për periudhën e vlerësimit 02.03.2020 - 14.06.2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 02.03.2020 - 14.06.2023, gjatë ushtrimit të detyrës së këshilltares ligjore pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillit të Lartë Gjyqësor. (lapsus në projekt-akt, pasi edhe siç u relatua më sipër në relacion znj. {...} ka qenë e komanduar nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillit të Lartë Gjyqësor).

2. Caktimin e znj. Emona Muçi si relatore për vlerësimin e gjyqtares së komanduar, znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Me shqyrtimin e kësaj pike të këtij rendi dite, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Fundjavë të qetë.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor